VENDIM
Nr. 270, datë 29.4.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.535, DATË 8.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE NË KOMUNITET"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.535, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalia hyrëse e pikës 3, të kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Punëdhënësit paraqesin kërkesën për përfshirjen në program nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*", me dokumentacionin e mëposhtëm: ...".

b) Kudo në përmbajtjen e vendimit, fjala "aplikim" zëvendësohet me "kërkesë".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj